



VENDIM

Nr. 1, Datë 01.02.2010

"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË STATUTIT TË RI TË AKADEMISË SË ARTEVE"

Senati i Akademisë së Arteve në mbledhjen e datës 01.02.2010, Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse për ndryshime,

VËREN SE

Në bazë të nenit 14 e 39 të ligjit 9741, datë 21.05.2007, Senati Akademik i Institucioneve të Arsimit të Lartë ka kompetencën për të miratuar dhe ndryshuar statutin e vetë institucionit.

Statuti me të cilin rregullohet jeta universitare në Akademinë e Arteve është miratuar në vitin 2008, duke parashikuar një sërë rregullash lidhur me organet drejtuese administruese, strukturat e tjera të Akademisë, qofte akademike apo administrative. Statuti aktual parashikon gjithashtu rregulla për ciklet e studimit dhe programet mësimore, etj.

Megjithatë ky statut ka nevojë për ndryshime edhe thelbësore, nevoja këto të dala nga praktika dhe zhvillimi i jetës universitare në Akademinë e Arteve, apo të sugjeruara apo rekomanduara si nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, ashtu edhe nga struktura apo individë brenda Akademisë së Arteve. Ndryshimet kryesore janë si bërë në çështjet e mëposhtme:

- Mënyra e funksionimit të Rektoratit , në përputhje me kërkesën e nenit 15, pika 7 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Përcaktimi i numrit, përbërjes, mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve, vendet vakante që mbeten me mbarimin e mandatit për organin drejtues të Këshillit të Administrimit, si dhe funksionimin e këtij këshilli.
- Përcaktimi i të drejtat, detyrat, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Etikës, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.
- Detyrat e Këshillit të Profesorëve, duke pasur parasysh përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 864 datë 05.12.2007 "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor".
- Funksionimin e Këshillit të Profesorëve
- Përbërja e departamentit, sipas nenit 12, pika 3 e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.
- Pozita e përgjegjësit të departamentit, zgjedhja e tij, titujt akademik që duhet të ketë, kompetencat e tij.
- Tarifat e studimeve, ku përfshihet tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit, sipas nenit 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.
- Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe kontrolli i auditit të brendshëm, në bazë të neneve 59 dhe 81 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Hartimi i buxhetit;
- Kriteret për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, në rastin e transferimit të tij, sipas pikës 2, të nenit 35, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe periudhave të studimeve në përputhje me nenin 38 të ligjit për arsimin e lartë dhe në statut të shpjegohen konkretisht kërkesat dhe procedura e realizimit të tyre, sipas nenit 38/3 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.



- Viti akademik sabatik.
- Modalitetet, procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e këshillave studentorë.
- Kriteret për punësim për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ, në përputhje me nenin 50, pika 1 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.
- Procedura që ndiqet për marrjen e masave disiplinore.
- Procedura për përzgjedhjen e kandidatit fitues, në përputhje me nenin 50, pika 2 e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.
- Kriteret e përgjithshme për pranimin e personelit akademik të ftuar dhe të atij me kontratë të përkohshme.
- Procedura që ndiqet për marrjen e masave disiplinore.
- Kërkimi shkencor dhe shërbimet e institucioneve të arsimit të lartë, siç përcaktohet në nenet 69, 70 dhe 71 të ligjit nr. 9471, datë 21.05.2007.

Përveç ndryshimeve të mësipërme, statuti ka pësuar edhe ndryshime nga pikëpamja strukturore, me qëllim realizimin e një dokumenti me rrjedhje logjike të përmbajtjes. Organizimi i përmbajtjes është bërë në pjesë, krerë dhe nene, duke synuar në lehtësimin e këshillimit të këtij dokumenti.

Për sa më sipër, bazuar në nenet 14 e 39 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI

1. Miratimin paraprak të Statutit të ri të Akademisë së Arteve, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Dërgimin e Statutit të ri, për miratim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Gazmend LEKA

Prof Asoc. Arben LLOZI

Prof. Ibrahim MADHI

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Sokol SHUPO

Prof. Asoc Rudina CIKO

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Asoc. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Sadik SPAHIJA

Prof. Astrit SELITA

Prof. Asoc. Ilirjan MARTINI

Prof. Asoc. Mehmet XHELILI

Benard LAZE

Kujtim HALILI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Miranda BAKIASI

Ramazan GURRA